



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr _____ Prot _____

Vau Dejës me ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 36 Datë 28.06, 2021

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/l" (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligji nr 38/2019, ligji nr 8744 datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore" ndryshuar, në VKM-në nr 68 datë 28.01.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodres", ndryshuar me VKM nr 246, datë 31.03.2011, "Për disa ndryshime në VKM nr 68 datë 28.01.2008, në VKM nr 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit nr 02 datë 05.03.2021, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit, Sektori i Aseteve, ku propozohet "Për dhënien në përdorim me afat deri në 20 vjet të pasurisë nr 366/2, Zk nr 1100, e llojit "Terren Sportiv", me sipërfaqe 10 300 m², në fshatin Barbullush. Pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies në përdorim me afat deri në 20 vjet të pasurisë nr 366/2 Zk nr 1100, e llojit "Terren Sportiv", me sipërfaqe 10 300 m², në fshatin Barbullush
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

K R Y E T A R

Mark BISHA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.07.2021

